



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.173 dt.04.12.1998

**“PER  
MIRATIMIN E KRITEREVE PER FAMILJET QE KANE AKT –  
MARVESHJE TE PA ZBATUARA ME PUSHTETIN LOKAL”**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, i mbledhur në dt.04.12.1998, pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtorisë së Ndërtim Strehimit “Për miratimin e listës së familjeve që kanë akt – marrëveshje të pa zbatuara me Pushtetin Lokal”, nisur nga shkresa e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Nr.4011, prot, dt.22.10.1998 ku kërkohet dërgimi i listave të qytetarëve me akt – marrëveshje dhe me shkresën me Nr.4012, prot, dt.22.10.1998, P/Vendimin për fondin prej 17.000 mijë lekë bazuar dhe në Ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 neni.14, pika.14, “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”

**VENDOSI**

1. Meqë numri i qytetarëve që duan të trajtohen sipas P/Vendimit të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit është më i madh se fondi i akorduar, të miratohen në parim kriteret trajtimit me përparësi të qytetarëve me akt marrëveshje të pa zbatuara me Pushtetin Lokal.(akt – marrëveshje duhet të jetë origjinale)

**A. Të shpronësuar në truall në momentin e shpronësimit.**

**B. Afati kohor i lidhjes së akt – marrëveshjes, dhe ai i dorëzimit të dokumentave.**

**C. Në fund të listës do të renditen akt – marrëveshjet me Ushtrinë.**

**D. Qytetarët që ngelen pa u trajtuar nga kjo listë kanë përparësi në të ardhmen.**

2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve (Drejtoria e Ndërtim Strehimit).
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefektura.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**